



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Adresa: Bulevardi "Zog I", Godina 57/2, Nr. 18 Tiranë,

Tel/Fax: 04 2268141; 2268142

Nr. 557/6 Prot.

Tiranë, më 13.12.2016

**V E N D I M**

Nr. 158, Datë 13/12/2016

**Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Drejtorisë së Bujqësisë Kukës dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar dhe në zbatim të planit vjetor të punës, miratuar me vendimin nr. 1, datë 06.01.2016, të Komisionerit, nëpërmjet vendimit nr. 138, datë 30.12.2015, "*Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil, në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe në institucionet e varësisë që janë pjesë e shërbimit civil*", Komisioneri ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe në institucionet e varësisë që janë pjesë e shërbimit civil dhe konkretisht në institucionin e Drejtorisë së Bujqësisë Kukës,

**VËREJ SE:**

Me vendimin nr. 138, datë 30.12.2015, "*Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe institucionet e varësisë që janë pjesë e shërbimit civil*", Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka vendosur fillimin e procesit të mbikëqyrjes së përgjithshme në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe institucionet e varësisë që janë pjesë e shërbimit civil. Bazuar në këtë vendim, ka vijuar mbikëqyrja edhe në institucionin e Drejtorisë së Bujqësisë Kukës.

Objekti i mbikëqyrjes përfshin veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në proceset e administrimit të shërbimit civil, prej momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, e në vijim.

Procesi është zhvilluar në përputhje me Programin e Mbikëqyrjes nr. 557 prot., datë 07.09.2016, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i cili me shkresën nr. 557/1 prot., datë 07.09.2016, *“Njoftim në lidhje me mbikëqyrjen në Drejtorinë e Bujqësisë Kukës”*, i është njoftuar Drejtorisë së Bujqësisë Kukës.

Drejtoritë e Bujqësisë përfshihen për herë të parë në shërbimin civil me ligjin nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar sipas parashikimeve të nenit 4, pika 1, shkronja *“a”*. Përfshirja e drejtorive të bujqësisë në listën e institucioneve të administratës shtetërore, që hyjnë në fushën e shërbimit civil, është parashikuar në mënyrë të shprehur në lidhjen nr. 1, (me numër rendor 88), që është pjesë e vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, i ndryshuar me VKM nr. 262, datë 25.3.2015.

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit dhe grumbullimit të të dhënave, grupi i mbikëqyrjes ka hartuar projektraportin për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil dhe ia ka dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrur me shkresën nr. 557/2 prot., datë 14.11.2016, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, *“Dërgohet projektraporti në përfundim të mbikëqyrjes në Drejtorinë e Bujqësisë Kukës, në lidhje me administrimin e shërbimit civil”*, duke i lënë një afat 15 ditë kohë për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara nga grupi i mbikëqyrjes.

Me shkresat nr. 557/3 prot., datë 14.11.2016 dhe nr. 557/4 prot., datë 14.11.2016, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, *“Dërgohet projektraporti në përfundim të mbikëqyrjes në Drejtorinë e Bujqësisë Kukës, në lidhje me administrimin e shërbimit civil”*, projektraporti i mbikëqyrjes i është dërguar për njohje, respektivisht, Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, që është ministria nga e cila varet institucioni i mbikëqyrur dhe Departamentit të Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse në këtë rast.

Ndërkohë subjekti i mbikëqyrur, pasi është njohur me projektraportin, me shkresën nr. 50311 prot., datë 21.11.2016, *“Dërgojmë projektraportin”*, ka dërguar projektraportin e nënshkruar nga personat përgjegjës, duke qenë dakord me të gjitha gjetjet e grupit të punës të pasqyruara në të.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

#### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, referuar Seksionit III, *“Procedura hetimore”*, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, si dhe Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

## V E N D O S A:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Drejtorinë e Bujqësisë Kukës, i cili është pjesë e këtij vendimi dhe të paralajmërojë institucionin për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke kërkuar zbatimin e detyrave që do të specifikohen më poshtë.
2. Njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike si dhe njësia e burimeve njerëzore të institucionit të mbikëqyrur, duhet të marrin masa dhe të tregojnë kujdes, që për çdo procedurë që ka lidhje me menaxhimin e shërbimit civil, të bëjnë administrimin e tyre edhe në mënyrë shkresore sipas kërkesave të ligjit dhe me qëllim kontrollin e zbatimit të ligjit në administrimin e shërbimit civil nga nëpunësit përgjegjës, në përputhje me hierarkinë administrative, ashtu dhe nga institucionet e ngarkuara nga ligji për mbikëqyrjen e shërbimit civil

Në këtë këndvështrim, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore duhet të finalizojë procesin e hartimit të përshkrimeve të punës, duke u kujdesuar që të merret mendimi i Departamentit të Administratës Publike dhe më tej të depozitohet ato në arkivin e institucionit, si dhe pranë Departamentit të Administratës Publike.

3. Njësia e burimeve njerëzore të Drejtorisë së Bujqësisë Kukës, në lidhje me procesin e planifikimit vjetor të pranimit në shërbimin civil, duhet të mbajë parasysh rastet e mbushjes së moshës së pensionit, parashikimin e vendeve të reja në shërbimin civil dhe të marrë masa për realizimin e tij në përputhje me afatet dhe procedurat respektive, të parashikuara në mënyrë të detajuar në pikën 5, 7 dhe 8, të Vendimit nr. 108, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”.
4. Për të rregulluar ligjshmërinë e procesit të ristrukturimit në institucionin e Drejtorisë së Bujqësisë Kukës, njësia përgjegjëse (DAP), në kuptim të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duhet të marrë masa që për punonjësit \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\* të cilët janë transferuar në pozicione jashtë shërbimit civil, të ndryshojë pjesërisht aktin nr. 3126/1, datë 24.06.2015, “Mbi transferimin e disa nëpunësve për shkak të ristrukturimit të Drejtorisë së Bujqësisë Kukës”, në pikën 2 dhe 3, duke ndjekur hapat si më poshtë:

- Të nxjerrë aktet individuale të lirimit nga shërbimi civil, për punonjësit \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\* , për shkak të përfundimit të marrëdhënies së punës, në kuadër të ristrukturimit të Drejtorisë së Bujqësisë Kukës.
- Në kuptim të nenit 50, pika 8, germa “a”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, t’u njohë punonjësve \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\* , të drejtën që brenda periudhës 2-vjeçare, nga data e përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil, të konkurrojnë si nëpunës civilë për procedurën e lëvizjes paralele apo të ngritjes në detyrë, në pozicione pune të shërbimit civil dhe të njoftohen punonjësit për këto akte.

5. Njësia e burimeve njerëzore të Drejtorisë së Bujqësisë Kukës dhe personat përgjegjës, të ngarkuar nga ligji me detyrën e vlerësimit të rezultateve në punë, duhet të mbajnë parasysh orientimet e Komisionerit, të cilat janë të materializuara në raportin e mbikëqyrjes, më qëllim kryerjen e vlerësimit të rezultateve në punë në mënyrë sa më objektive, duke e lidhur procesin me realizimin e detyrave konkrete të secilit nëpunës.
6. Njësia e burimeve njerëzore të Drejtorisë së Bujqësisë Kukës, në respektim të nenit 61, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, për nëpunësit \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\* , ndaj të cilëve është marrë masa disiplinore “*Vërejtje*”, duhet të ndërmarrë hapat si më poshtë:
  - Të vendosë shuarjen e masës disiplinore “*Vërejtje*”, të marrë ndaj nëpunëses \*\*\*\*\* , me urdhrin nr. 37, datë 15.07.2014;
  - Të vendosë shuarjen e masës disiplinore “*Vërejtje*”, të marrë ndaj nëpunësit \*\*\*\*\* , me Urdhrin nr. 38, datë 15.07.2014;
  - Masat e mësipërme disiplinore të fshihen nga dosjet e personelit dhe nga regjistri përkatës.
7. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **30** ditë nga marrja dijeni për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim duke u bazuar në orientimet e dhëna në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.
8. Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, Drejtoria e Bujqësisë Kukës, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
9. Për këtë vendim të njoftohet Drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë Kukës, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe Departamenti i Administratës Publike, duke i dërguar një kopje të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe njëkohësisht, të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë.
10. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**